

Informacione për Ligjin mbi ndihmën për viktimat

1. Çfarë është Ligji mbi ndihmën për viktimat?

Ligji federal mbi ndihmën për viktimat e veprave penale të datës 23 mars 2007 (Opferhilfegesetz, OHG, SR 312,5) nga data 1 janar 2009 zëvendëson ligjin e deritanishëm të datës 4 tetor 1991 mbi ndihmën për viktimat. Qëllimi i këtij ligji është që të prekurve t'u jepet ndihmë dhe të përmirësohet statusi i tyre juridik. Këtu përfshihen:

- këshillimi profesional dhe përkujdesja profesionale
- mbrojtja e viktimës dhe ruajtja e të drejtave të saj në procedurën penale
- dëmshpërblimi i përshatshëm dhe shpagimi moral

2. Për kë vlen Ligji mbi ndihmën për viktimat?

Ndihmë sipas këtij ligji merr çdo person të cilit nëpërmjet një veprë penale i është cenuar në mënyrë të drejtpërdrejtë integriteti fizik, seksual ose psikik (viktima), dhe këtë ndihmë e merr parvarësisht nga fakti a është hetuar autori i veprës dhe a ka vepruar autori me faj (neni 1 OHG). Në këto vepra penale përfshihen: plagosja, vrasja, përdhunimi, shtrëngimi seksual dhe shfrytëzimi seksual, kanosja e rëndë dhe shtrëngimi i rëndë, heqja e paligjshme e lirisë, marrja peng, aksidentet në trafik me pasojë lëndimi ose vdekjeje. Nuk përfshihen veprat kundër dinjitetit, rrahja, vjedhja ose mashtrimi, sepse këto vepra penale nuk mund të shkaktojnë një cenim të drejtpërdrejtë të integritetit. Të afërmit e ngushtë të viktimës (p.sh. bashkëshortët, partnerët e jetës, prindërit ose fëmijët) kanë të drejta të barabarta me viktimën lidhur me këshillimin, ndërsa të drejtën për dëmshpërblim ose shpagim moral të afërmit e kanë vetëm në përmasa të kufizuara. Ata duhet t'i kërkojnë vet të drejtat e tyre.

3. Çfarë të drejtash ka viktimat?

Këshillimi dhe përkujdesja

Viktimat kanë të drejtë për t'u këshilluar pa pagesë prej një nga institucionet e njohura të këshillimit. Këto institucione u japin të prekurve ndihmë mjekësore, psikologjike, sociale, materiale dhe juridike ose ndihmojnë duke ndërmjetësuar për të marrë ndihmën përkatëse. Ndihma mund të jepet ose mund të ndërmjetësohet si ndihmë e menjëhershme ose si ndihmë afatgjatë. Përveç kësaj institucionet këshilluese i informojnë viktimat mbi ofertat e ndihmës për viktimat.

Në ndihmat e menjëhershme përfshihen p.sh. gjetja e një strehimi të përkohshëm, ndërmjetësimi për marrjen e këshillimit juridik për sqarimin fillestar të rastit, ose dhënja e asistencës kalimtare. Shpeshherë ndihmat e menjëhershme nuk janë të mjaftueshme për të përballuar pasojat e situatës së viktimës. Në këtë rast, në varësi nga rrethanat financiare (këtu merren parasysh të ardhurat dhe pasuria), mund të paguhet kontribute në shpenzimet për ndihmën afatgjatë të dhënë nga persona të tretë (psikoterapia, shpenzimet e avokatit, ndihma familjare). Mbi ndihmën afatgjatë vendos Zyra për Shëndetësinë dhe Çështjet Sociale në bazë të një kërkesë.

Të drejtat në procedurën penale

Në se kundër autorit ose autores së veprës fillohet një procedurë penale, viktima në çdo rast gëzon një mbrojtje më të mirë juridike. Viktima mund të kërkojë që

- gjykimi penal të zhvillohet me dyer të mbyllura;
- të mos e takojë autorin e veprës gjatë procedurës penale;
- të shoqërohet nga një person i besuar, kur duhet të japë deklaratë në cilësinë e dëshmitarit ose dhënësit të informatave;
- në rast të një veprë penale kundër integritetit seksual të merret në pyetje nga një person i të njëjtës gjini. Sipas një parimi të përgjithshëm viktima mund të refuzojë të japë përgjigje lidhur me pyetje që kanë të bëjnë me sferën e saj intime.

Dëmshpërblimi dhe shpagimi moral

Viktima dhe të afërmit e saj kanë të drejtë të marrin një dëmshpërblim për dëmin e pësuar në rast të cënimit ose vdekjes së viktimës (neni 19 OHG). Nuk merret parasysh dëmi material. Në rrethana të caktuara mund të kërkohet një parapagesë në dëmshpërblim (neni 21 OHG). Në qoftë se pesha e cënimit e justifikon këtë, atëherë viktima dhe të afërmit kanë të drejtë për shpagimin moral (kompensim i vuajtjes së pësuar).

Kërkesat për dëmshpërblim dhe shpagim moral duhet të parashtrohen **brenda pesë viteve nga kryerja e veprës penale**, përndryshe ato të drejta shuhet (neni 25 OHG). Kompetent është kantoni në të cilin është kryer vepra penale (neni 26 OHG). Në rast të një veprë penale të pësuar jashtë shtetit nuk jepen dëmshpërblime dhe shpagime morale (neni 3 OHG).

4. Çfarë mund të ndërmarrë viktima e një veprë penale?

Personi i prekur, menjëherë pas ndodhjes së veprës penale mund të lajmërojë policinë nëpërmjet numrit të urgjencës 117 ose mund të paraqitet personalisht në postin më të afërt të policisë. Gjatë marrjes në pyetje policia jep informacionet më kryesore rreth Ligjit mbi ndihmën për viktimat dhe adresën e zyrës së këshillimit të viktimave në kantonin Schwyz. Jashtë orarit të punës së zyrës së këshillimit të viktimave mund të këshillohet në mënyrë anonime nëpërmjet numrit telefonik 143 të "Dorës së Zgjatur". Por viktima edhe mund t'i drejtohet vet menjëherë pas veprës penale njërës prej zyrave të njohura të këshillimit.

Opferhilfe Ligjin mbi ndihmën për viktimat

Beratungsstelle / Këshillimi Kanton Schwyz

Gotthardstrasse 61a

6410 Goldau

Tel. 0848 821 282

Fax 041 857 07 43

opferhilfes@arth-online.ch

www.arth-online.ch/opferhilfe